REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 56/17
Datë/Datum. 05.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 56/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina-Kryetar, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Nuhi Paçarizi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Hajdini Comerc"-Gllogoc, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur e aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me artikuj ushqimorë për nevojat e kuzhinës së institucioneve parashkollore në Prishtinë" me nr. prok. PR 616/16/169/111, iniciuar nga AK-/Komuna Prishtinës/ më datën 03.04.217 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Hajdini Comerc"-Gllogoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me artikuj ushqimorë për nevojat e kuzhinës së institucioneve parashkollore në Prishtinë" me nr. prok.PR 616/16/169/111 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /Komuna Prishtinë/.

II. **Anulohet,** njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së /Komuna Prishtinë/, lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Furnizim me artikuj ushqimorë për nevojat e Kuzhinës së institucioneve parashkollore në Prishtinë" me nr. prok. " me nr. prok. PR 616/16/169/111, si i pa bazuar, dhe lënda kthehet në **Ri –Vlerësim**, me qëllim të vërtetimit të çmimeve të ofruara nga të gjithë operatorët ekonomik ofertues.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj;

V. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Hajdini Comerc" Gllogoc, janë të qëndrueshme, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:30.11.2016.
Hapja e ofertave është bërë me dt:27.12.2016, ku kanë marr pjesë gjashtë operator ekonomik.
Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me ketë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:26.01.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik OE "Neë Line&Bajraktari.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "Hajdini Comerc" Gllogoc me dt:16.02.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:16.02.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Hajdini Comerc" Gllogoc,

Operatori ekonomik ankues "Hajdini Comerc" Gllogoc, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 24 shkurt 2017 me nr. 56/17 kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit,"Furnizim me artikuj ushqimorë për nevojat e kuzhinës së institucioneve parashkollore në Prishtinë"me nr. prokë. " me nr. prok. PR 616/16/169/111, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues AK-Komuna Prishtinë duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Neni 1 - Qëllimi;
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
- Neni 61 – Tenderët jo-Normalisht te ulët;
- Neni 42 – UOPP-se;
- Rregullat për çmime Jo-Normalisht të ulëta.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 08.02.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 20.03.2017 bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Komuna Prishtinë**, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me artikuj ushqimor për nevojat e kuzhinës së Institucioneve parashkollore në Prishtinë", me numër të prokurimit: PR616/16/169/111, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. Prandaj eksperti shqyrtues i ka propozuar panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe njëherit ka propozuar që ankesa e OE ankues te refuzohet si e pa bazuar.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë:21.03.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Operatori ekonomik ankues me datë: 21.03.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 03. 04. 2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti e OSHP-së, vëzhguesit nga OJQ "D Plus" u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Hajdini Comerc"-Gllogoc ka deklaruar: Ne kemi parashtruar ankesë lidhur me çmime jo normalisht të ulëta, dhe pikë tjetër është mishi i freskët. Ka edhe edhe pika tjera për çmime me 1 cent etj, mirëpo mishi i freskët është dhënë 0.70 € për kilogram, mish i freskët tul viçi, ndërsa lëkura e viçit kushton 3.5 €.

Ne kemi pas edhe vitin e kaluar me KK Prishtinë nga viti 2016, kur kemi fituar tenderin specifikat e artikujve emërtimet e artikujve, mish të freskët tul nuk ka pas në kërkesë, vetëm mish i bluar i freskët. Si rrjedhojë si bazë për dyshim është se ne kemi bërë mirë pasi kemi pas të bëjmë me furnizim por edhe jemi pajtuar 70% e mishit të dërgohet si mish tul, për hir që të mos ketë probleme në furnizim për ushqim.

Për këtë mendojmë se edhe ka arritur të ofrohet çmimi 0.70 € për kilogram të mishit të freskët. Po ashtu OE i rekomanduar ka ofruar çmime prej 0.01€ për sallatë të gjelbër, mielli bardhë p.sh është çmim 0.02 €, etj.

Anëtari i panelit shqyrtues z. Sylejmani pyeti përfaqësuesin e OE ankues se sa është çmimi i tregut për Mish të freskët?

Në përgjigje përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: Çmimi i tregut për mish tul është nga 4 € deri 6 €.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi AK-KK Prishtinë ka deklaruar: Me këtë aktivitet të prokurimit ka kërkesa për mish tul dhe mish të bluar, për dallim nga kontrata e kaluar. Ne pajtohemi me mendimin dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues. Kërkojmë nga paneli të vërtetoj vendimin e AK dh të refuzoj të pabazuar ankesën e OE ankues. Ne si AK kemi kërkuar sqarime shtesë për çmimet e OE të rekomanduar për kontratë, dhe e njëjta ka dhënë sqarime të mjaftueshme. Po ashtu kemi kërkuar mbulesë nga OE në fjalë, dhe ka bërë sigurim të ekzekutimit në vlerë 20% të kontratës, dhe kemi njoftuar KRPP-në.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues i cili deklaroj: Komisioni vlerësues ka vërejt çmime që pretendon OE, si jo normalisht të ulëta. Lidhur me këto çmime konform nenit 61 AK-ja ka dërguar kërkesë për sqarim të çmimeve për të cilat edhe ka dhënë përgjigje OE i rekomanduar për kontratë.

Anëtari i panelit shqyrtues z. Sylejmani pyeti ekspertin shqyrtues se çfarë është sqarimi i OE të rekomanduar për kontratë, për çmime, a ka elaborim apo analizë të çmimit?

Në përgjigje eksperti shqyrtues deklaroj: OE ka dhënë një përgjigje, mirëpo analizë detale të çmimit nuk ka dhënë. Ka deklaruar se do mbuloj kontratën dhe ka kërkuar njëherit nga AK që ti rritet siguria ekzekutimit në rast se dyshon se nuk do realizohet kontrata.

Anëtari i panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e AK-së, se a ka pozicione OE i rekomanduar për kontratë me çmime abnormalisht të larta?

Në përgjigje përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Jo nuk ka çmime abnormalisht të larta.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: Ne qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe i propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi AK-së deklaroj: Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit shqyrtues që të njëjtin ta vërtetoj si të bazuar duke refuzuar ankesën e OE ankues.

Në fjalën përfundimtar eksperti shqyrtues deklaroj: qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 23.03.2017.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit duhet të veprojë konform nenit 61 të LPP-së dhe njëkohësisht të ketë parasysh edhe rregulloren për tenderë Jo-Normalisht të ulëta. Si shembull konkret OE i rekomanduar për kontratë : për një kilogram te mishit te freskët viçi ka dhënë çmimin prej shtatëdhjetë cent (0.70 €) ose miell i bardhe me çmim dy cent (0.02 €) dhe artikuj tjerë qe nuk janë as për se afërmi me çmime te tregut. Por pasi që diferenca e OE te rekomanduar për kontrate dhe OE ankues është shumë e vogël, rreth dy mijë e dyqind e dymbëdhjetë euro (2,212.00 €), atëherë duhet te shikohen edhe çmimet e OE ankues se a ka ofruar çmime Jo-Normalisht të ulëta pra edhe çmimet e OE ankues a janë të afërm me çmimet e tregut.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se autoriteti kontraktues duhet të kërkojë sqarime shtesë për të vërtetuar çmimet e ofruara nga operatori ekonomik i rekomanduar për

kontratë dhe për të gjithë operatorët ekonomik ofertues Konform nenit 61 te LPP-së **Tenderët Jo-Normalisht të Ulët,** për te pasur me te lehte te shfrytëzoj Formularin B 57 te Legjislacionit dytësor të KRPP-së (Rregullat për tenderët Jo-Normalisht të ulët) ku konform *"**Neni 4 Procedura e shqyrtimit (inter partes)** 4.4 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulet, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar;". 4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose: Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, **të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë**; ose Nëse sqarimi nuk mjafton, **të refuzoj tenderin dhe,** ne përputhje me nenin 61 te LPP-se **të njoftoj KRPP**, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "**Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet**", brenda dy dite nga data e vendimit.* Pra nëse OE-te arrijnë te faktojnë se çmimet e ofruara për artikuj janë fitimprurës, konform cilësive te furnizimeve te kërkuara ne FTD atëherë AK duhet te konsideroj si tender normal e ne te kundërtën ti ***refuzoj si tender abnormalisht te ulet***.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart si dhe duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesues i Paneli Shqyrtues

Z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Prishtinë

1x1 OE " Hajdini Comerc"-Gllogoc,

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.